



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

**Nr. 18**

**Datë: 08. 06. 2023. Ora: 13:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

#### **1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.13/2023 dhe Nr. 16/2023

#### **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

#### **3. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**
- Shqyrtimi dhe miratimi i organizimit i takimeve të KQZ me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale
- Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë së trajnimit të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve
- **Këshilli për Buxhet dhe Financa**
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimit për derivate janar-mars 2023
- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**
- Shqyrtimi i ftesës së IDEA, KQZ e Shqipërisë dhe Qendra Rule of Law e Finlandës, në Tryezën e rrumbullakët Regjionale “ Digjitalizimi i proceseve zgjedhore: Perspektiva në ndërhyrjet kibernetike dhe koordinimi ndër-institucional mes vendeve të Ballkanit Perëndimor”

## Të ndryshme!

---

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes nr.13/2023 dhe Nr. 16/2023

**Kryetari Radoniqi**, e hapi mbledhjen dhe e paraqiti agjendën. Ai, i pyeti anëtarët nëse pajtohen me këtë rend dite. **Arianit Elshani**, kërkoi që pikat nga KOZ-i të largohen, pasi ato janë ende në shtyrtim nga këshilli...

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota miratuan rendin e ditës, ndërsa që u pajtuan të largohen nga rendi i ditës “dy pikat” nga KOZ.

Në vazhdim, u miratuan edhe procesverbalet nga mbledhjet e kaluara: 13, 16 dhe 17/2023.

### 2. Aktivitetet e SKQZ-së:

**Burim Ahmetaj, krye shëf tha se** Ministria e Financave dhe Punës dhe Transfereve më 15 maj ka lëshuar Qarkoren e Parë Buxhetore 2024/01, e cila përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor për vitet 2024-2026 dhe, kalendarin buxhetor. Nëpërmjet këtij dokumenti do të sigurohen informata dhe udhëzime mbi tavanet e shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal 2024 dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale. MEF, ka informuar edhe mbi metodologjitë të cila duhet të shfrytëzohet gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarjen buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet për dy vitet tjera pasuese.

Si e dini, tha z. Ahmetaj, në muajin mars, KQZ ka miratuar KASH-in për vitet 2024-2026, dhe vlerësohet se nga ai moment, ka filluar procesi i planit të buxhetit të KQZ-së për vitet 2024-2026, dhe kjo do të shërbejë si pikëmbështetje dhe bazë për hartimin e planit të buxhetit. Për të përmbushur këtë obligim ligjor, dhe për të përgatitur këtë plan. Kështu, sekretariati ka kërkuar nga secili zyrtar i SKQZ-së përfshirë edhe ZRFKFSF i cili është përgjegjës për departamentin, njësinë, divizionin apo zyrën të hartojë dhe përgatis kërkesat buxhetore dhe bashkëngjijtjen e planit për secilin projekt apo aktivitet për periudhën 2024-2026.

Duke pasur parasysh hapat dhe procedurat e përgatitjes së këtij dokumenti deri në miratim nga KQZ, sekretariati e ka draftuar buxhetin e KQZ-së 2024-2026 dhe tani DAP -i është duke përgatitur buxhetin në përputhje me udhëzimet për procesin buxhetor dhe kufijtë buxhetor për vitet 2024-2026. Bazuar në kalendarin kohorë të buxhetit nga MFPT më 26 qershor 2023, organizatat buxhetore duhet t'i dorëzojnë kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe sipas kategorive të shpenzimeve.

Në vazhdim të raportit mbi aktivitetet mes dy takimeve, Ahmetaj tha se Divizioni për Informim dhe Edukim i Votuesve, e ka përfunduar draft projektin “Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje”. Ky projekt ka për qëllim informimin dhe edukimin e të rinjve të cilët kanë mbushur ose i mbushin 18 vjet, deri në zgjedhjet e ardhshme. Informimin e votuesve të rinj për të drejtën e tyre për të votuar, procesin zgjedhor, sistemin dhe procedurat zgjedhore, ndikimin që mund të ketë vota e tyre në zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Ne, tha z. Ahmetaj, planifikojmë që ky projekt të realizohet në të gjitha shkollat

e mesme të Kosovës. Nga të dhënat e pranuar nga MASHT-i, në shtator të këtij viti parashihet të jenë rreth 22.000 nxënës të klasave të 12-ta. Drafti aktualisht është në shqyrtim në Sekretariat dhe pastaj të prezantohet dhe shqyrtohet në një të mbledhjet e radhës të KOZ-it.

Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve, po ashtu e ka përfunduar draft projektin “Informimi i Votuesve për Caktimin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit”. Ky projekt ka për qëllim t’i informojë votuesit për caktimin dhe mundësinë e ndërrimit të QV-së në çdo kohë, deri në periudhën kohore dyzet (40) ditë para ditës së zgjedhjeve, mënyrën e identifikimit të QV-së, caktimin në qendra të reja të votimit dhe të drejtën për të kërkuar ndërrimin e tyre. Drafti aktualisht është në shqyrtim në Sekretariat dhe pastaj të prezantohet dhe shqyrtohet në një të mbledhjet e radhës të KOZ-it.

Lidhur me konkursin për “melodinë e përhershme e KQZ-së” që është aprovuar në mbledhjen nr. 17/2023 të datës 11.05.2023, tani ju informoj se konkursi është publikuar në ueb faqe dhe në rrjetet sociale të KQZ-së, e është shpërndarë për transmetim në RTK, Radio Kosova dhe për publikim në portalet e lajmeve. Ju informoj, tha z. Ahmetaj se për vlerësimin kompozimeve nga konkursi, i jemi drejtuar dekanit të fakultetit të arteve me kërkesë për caktimin e tre profesionistëve në komisionin për vlerësimin e kompozimeve, nga i cili kemi pranuar përgjigje pozitive. Konkursi për e melodinë e KQZ-së, është mbyllur me datën 5 qershor 2023, dhe kemi pranuar vetëm një ofertë por, sekretariati mendon që nuk është e mjaftueshme për të vazhduar me procesin. Na duhet ta ri përsërisim konkursin, ose paraprakisht do ta bëjmë vlerësimin dhe analizimin e kriterëve, të buxhetit dhe korrigjimet eventuale që të kuptojmë se pse ka pasur vetëm një aplikim...!

Ndër aktivitetet e tjera, z. Ahmetaj përmendi edhe zhvillimin e Softuerit të integruar të rezultateve (në proces); identifikimi i të gjitha ndryshimeve në Projekt Ligjin (PL) për Zgjedhjet e përgjithshme dhe draftimi i plotësim-ndryshimeve për harmonizimin e Rregullave zgjedhore me PL për Zgjedhjet e përgjithshme; Përgatitja e projektit për funksionalizimin e Qendrave Komunale të Numërimit përfshirë edhe simulimin e këtij procesi në 2 apo 3 komuna në bazë të Projekt Ligjit (PL) për Zgjedhjet e përgjithshme; Rishikimi i procedurave të votimit dhe numërimit; Rishikimi i Formularëve Zgjedhor; Rishikimi i listës së artikujve zgjedhor që përdoren në vendvotim, qendra të votimit, Qendra Komunale të Numërimit, Ekipet Mobile, Shërbim Votues, Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve; Plotësim – ndryshimi i Udhëzimeve Administrative në Sekretariatit.

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimit për derivate janar-mars 2023:**

**Sami Kurteshi**, tha se nuk po e shoh “strategjinë” në raport. Qysh a puna ? Kemi shpenzue mjaft kohë...? Çështja tjetër, aktivitetet janë përmend, disa në mënyrë telegrafike... Por, duhet shtuar “koha, afati, kur janë fazat, kur përfundojnë etj.”

**Ilir Gashi**, gjithashtu u ndal te aktivitetet, tek “ligji mbi zgjedhjet”, pra ligji ka kaluar në shqyrtimin e parë, dhe “pika e dytë” e raportit që e raportuat, lidhet me ligjin: ndryshimet, përshtatjet, me një fjalë kompatibiliteti... Në KOZ, duhet trajtue afatet, rrjedhat etj.

**Alban Krasniqi**, tha se “plotësim – ndryshimi i rregullave të brendshme” ka filluar punën grupi punues, por sic u tha, ligji në lexim të parë ka kaluar, mirëpo me hyrjen në fuqi, pjesë të ligjit prekin rregulloret

tona, po edhe rregullat zgjedhore... Ai, foli edhe rreth “melodisë”, konkursit dhe se, nëse mbyllet duhet referuar ligjit të prokurimit...pra, të shihet, pra çka do që ndërmerret të jetë e bazuar në ligj...

**Čemailj Kurtiš,** dua të them shkurtimisht se, thelbi është që tani të fokusohemi në atë që është më e rëndësishme. Pra, këtu të fokusohemi, si për shembull kjo me kuvendin. Ato që nuk janë çështje urgjente, të mos ngutemi por të veprohet mirë, mirëpo duhet të shohim ajo që kërkon përparësi...Çështjet tjera, të bëhet më ngadalë dhe me kujdes e mirë, nuk duhet shpejtuar...

**Ibrahim Selmanaj,** tha se ligji që sot pritet të aprovohet, do të nxjerrë shumë obligime për KQZ-në, pra sidomos në obligimet buxhetore-si për shembull organizimi i zgjedhjeve jashtë vendit...Por, edhe si do ti organizojmë qendrat komunale...etj. Por, duhet ti kryejmë detyrat, duhet koncentruar në punë...

**Kreshnik Radoniqi,** tha se, ndoshta qysh nesër mund ta bëjmë një plan të punës, sidomos kur janë në pyetje rregulloret...dhe, brenda këtyre dy muajve i përfundojmë...Shtatori, mos me na gjete pa miratimin e rregulloreve...

Mendoj që KOZ së bashku me Sekretariatit, ta bëjë një plan kush, çka do të punojë...Pra, duhet një plan, s’duhet me pritë...

**Arianit Elshani,** tha se duhet të merremi me rregullat. Sekretariati e ka shpërnda ligjin, dhe të bëhen analiza se ku, çka duhet ndryshuar...

**Burim Ahmetaj,** tha sekretariati tashmë e ka formën finale të Strategjisë, dhe së shpejti e përcjellim në KQZ. Do ta bëjmë një plan, sigurisht për këtë kohë...dhe, do të jemi aktivë....po punojmë për funksionalizimin e QV-e etj.

## **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

### **Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimit për derivate janar-mars 2023**

**Gordana Llaban:** Këshilli, është takuar më 11 maj kemi shqyrtuar shpenzimet në derivate perudhën janar-mars 2023. Në këtë periudhë, automjetet e KQZ kanë kaluar: 51. 382 kilometra. Janë shpenzuar: 3.366 litra karburant.

Anëtarët e KQZ-së, miratuanme vota unanime këtë raport

## **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

### **Shqyrtimi i ftesës së IDEA, KQZ e Shqipërisë dhe Qendra Rule of Laë e Finlandës, në Tryezën e rrumbullakët Regjionale “ Digjitalizimi i proceseve zgjedhore: Perspektiva në ndërhyrjet kibernetike dhe koordinimi ndërinstytucional mes vendeve të Ballkanit Perëndimor”**

**Burim Ahmetaj,** tha se është kjo ftesë nga IDEA, dhe është ftuar KQZ të marrë pejsë në tryesën e rrumbullakët me temën: “Digjitalizimi i proceseve zgjedhore: Perspektiva në ndërhyrjet kibernetike

dhe koordinimi ndërinstitutional mes vendeve të Ballkanit Perëndimor”. Tryeza zhvillohet me 4 dhe 4 korrik në Tiranë. Shpenzimet e udhëtimit, mbulohen nga projekti. Por, është bërë me dije se, KQZ, ka marrë rekomandim që dikush nga partnerët me të cilët bashkëpunon KQZ të marrë pjesë...sipas propozimit tonë...

Unë, do të marrë pjesë, por edhe dikush nga sekretariati, por shpenzimet i bartë KQZ. Nuk vendosëm në mbledhjen e KMJ-së...Ne, do komunikojmë...

**Alban Krasniqi**, tha se zyrtari i IT-së, merr pjesë se tema nënkuptohet...

**Kreshnik Radoniqi**: Po pajtohem, nëse lejohet vjen nga sekretariati, nëse jo, shkoj vetëm unë...

Me vota unanime, u miratua pjesëmarrja. Si në vijim, autorizohet komunikimi me organizatorin për të sqaruar faktin, nëse lejohet që dikush – përtej përcaktimit nga “ftesa” të marrë pjesë...

**Të ndryshme!**